

## **Ambasador Flamur GASHI - Këshilltar i Presidentit për Çështjet e Rajonit**

Flamur GASHI, ka lindur në Pejë - Kosovë, më 10 qershor 1969. Është diplomuar në Fakultetin e Letërsisë dhe Gjuhës Shqipe. Është kandidat për Doktor Shkence në të Drejtën Ndërkombëtare. Ka kryer disa trajnime për gazetarinë hulumtuese si dhe në fushën e diplomacisë, si në vend, ashtu edhe jashtë tij.

z.GASHI, ka kryer funksionin 'Këshilltar' të disa ministrave të Qeverisë së Republikës së Kosovës (1997-2000) - me seli në Tiranë. Nga viti 2001 deri në 2004, ka qenë Sekretar i Përgjithshëm në Asociacionin Kosovar të Atlantikut, me seli në Prishtinë.

Kontributi i z.GASHI, është gjithashtu i njohur dhe në fushën e gazetarisë dhe atë të studimeve politike.

z.Flamur GASHI, ka qenë bashkëpunëtor dhe gazetar në RTSH, Kryeredaktor dhe Drejtor i "Radio Kontakt", radios së parë private në Shqipëri, si dhe Redaktor në Revistën "Koha" dhe gazetën "Kosova".

z.GASHI, gjithashtu ka qenë zëvendës Kryetar i Bordit për Monitorimin e Mediave të Republikës së Shqipërisë.

z.GASHI, ka qenë Drejtor i Institutit Kombëtar të Diasporës Shqiptare në Ministrinë e Punëve të Jashtme - Tiranë; Drejtor Ekzekutiv i Institutit të Studimeve Politike -Tiranë; Drejtor i Qendrës Ndërkombëtare të Shtypit, me rastin e vizitës së Presidenti Xhorxh W. Bush në Tiranë.

Në maj të 2010 z.Flamur GASHI, është emëruar Ambasador i Jashtëzakonshëm dhe Fuqiplotë i Republikës së Shqipërisë në Bosnjë dhe Hercegovinë.

Nga tetori 2014 deri në gusht 2017, Ambasador Flamur GASHI ka qenë Këshilltar për Çështjet e Rajonit i Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sh. T. Z. Bujar Nishani.

Profesor Flamur GASHI, është ligjërues në Kolegjin AAB në Prishtinë.

Ambasador Flamur GASHI, është anëtar i Asamblesë së Këshillit të Ambasadorëve shqiptarë.

Nga gushti 2017 e në vazhdim Ambasador Flamur GASHI, është Këshilltar për Çështjet e Rajonit i Presidentit të Republikës së Shqipërisë, SH. T. Z. Ilir META.

Ambasador Flamur GASHI, është vlerësuar me dekorata mirënjohjeje dhe çmime të ndryshme të veçanta.

Profesor Flamur GASHI, numëron disa botime universitare si dhe artikuj të ndryshëm shkencorë në revista vendore dhe ndërkombëtare.

z.Flamur GASHI, është i martuar dhe ka tre fëmijë. Flet serbisht, kroatisht, gjermanisht dhe anglisht.